

Udhëzues i Shpejtë për Shkollimin në Shtëpi

Çfarë është Shkollimi në Shtëpi?

- Shkollimi në shtëpi është kur prindërit i mësojnë fëmijët e tyre në shtëpi, në vend që t'i dërgojnë në një shkollë publike, charter ose private. Prindërit ose kujdestarët janë përgjegjës për arsimin e fëmijës së tyre, duke përfshirë përzgjedhjen e kurrikulës që përmban lëndë të caktuara.
- Një prind ose kujdestar nuk ka nevojë të jetë i/e certifikuar, por duhet të ndjekë rregulloret e NYSED Pjesa 100.10 dhe të dorëzojë dokumentacion çdo vit në Zyrën e Shkollimit në Shtëpi të NYC.

Shënime të Rëndësishme

- Mësuesit nga shkollat publike të NYC nuk ofrojnë mësim, dhe nxënësit që shkollohen në shtëpi nuk marrin burime si kompjuterë, tekste shkollore ose qasje në shumicën e programeve të bazuara në shkollë, duke përfshirë sportet dhe aktivitetet jashtëshkollore.
- Nxënësit që shkollohen në shtëpi nuk marrin një diplomë të Shtetit të Nju Jorkut dhe as nuk fitojnë kredite të shkollës së mesme (HS).
- Diplomat nga shkollat vetëm-online nuk njihen nga Shteti i Nju Jorkut, por programet online mund të jenë pjesë e planit tuaj të shkollimit në shtëpi (IHIP). Edhe nëse një program online përdor fjalë si “i akredituar (accredited)” ose “i certifikuar (certified)”, nxënësi juaj nuk do të marrë diplomë të Shtetit të Nju Jorkut.
- Pasi një nxënës të mbushë 17 vjeç dhe të ketë përfunduar vitin shkollor në të cilin i mbushi 17, ai/ajo mund të aplikojë për provimin e Barazvlefshmërisë së Shkollës së Mesme të NYS (GED).
- Nëse fëmija juaj ka një gjendje mjekësore që e pengon të ndjekë shkollën, mund të keni të drejtë për mësim të nevojshëm për arsye mjekësore ose mësim në shtëpi përmes NYCDOE — mund t'i kontaktoni në hiapply@schools.nyc.gov
- Nëse fëmija juaj shkollohet në shtëpi dhe ka nevojë për shërbime të arsimit special, duhet t'i kërkonit këto shërbime me shkrim drejtpërdrejt në Komitetin Lokal për Arsimin Special (CSE). Kërkesa duhet të dërgohet deri më 1 qershor për vitin shkollor pasardhës.

Detyrimet e Prindit

- Përzgjidhni kurrikulën dhe sigurohuni që fëmija juaj të marrë mësimin e nevojshëm. Mund të përdorni tutorë ose programe online, por jeni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe të gjithë raportimin e kërkuar.
- Siguroni të gjitha materialet mësimore.
- Dorëzoni të gjithë dokumentet çdo vit – LOI, IHIP, Raportet Tremujore dhe Vlerësimin Vjetor.
- Mbikëqyrni të mësuarit e fëmijës dhe mbani shënime të detajuara mbi mësimin, përparimin, vlerësimet dhe praninë. Gjithashtu duhet të siguroheni që të plotësohen orët e detyrueshme mësimore:
Klasat 1–6: 900 orë/vit
Klasat 7–12: 990 orë/vit

Kontakt

- Hapat e detajuar, modelet, burimet dhe rregulloret Pjesa 100.10: schools.nyc.gov/home-schooling
- Për pyetje mbi regjistrimin & pranimin: LetterofIntent@schools.nyc.gov
- Për pyetje mbi mësimdhënien: Homeschool@schools.nyc.gov
- Telefononi 718 935 2343